



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.18, datë 22/12/2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME SANITARE, TË SUBJEKTIT “TIRANA DUE” SH.P.K.,
ME VENDNDODHJE: AUTOSTRADA TR-DR KM5, RRUGA “MONUN”,
BASHKIA TIRANË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime sanitare, të subjektit “Tirana Due” sh.p.k., me vendndodhje: Autostrada Tr-Dr km5, Rruga “Monun”, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor:

- X= 478433.20
- Y= 4580265.57
- Z= 102 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 1$ l/sek
- Qëllimi i përdorimit : Për qëllime sanitare.
- Thellësia e pus-shpimit: 11 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 10.5 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

$X = 478556.96;$

$Y = 4580239.820;$

$Z = 100$ m

- Prurja që shkarkohet: $Q = 1$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ISHËM

EMILJAN JANI

